



Prishtinë: 10.07.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1175_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1937_05_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **10.06.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin L.B. nga fshati Drenushë, Prishtinë, me shifër të konsumatorit DPR 41550, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1937_05_19** i datës 10.05.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 10.06.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se KESCO e ka refuzuar ankesën e konsumatorit pasi që gjendja e regjistruar në njehsor në atë periudhë ka qenë në rregull dhe janë korrigjuar faturat e kontestuara. KESCO në ankesë ka theksuar se vendimi i DMK në ZRRE thekson se nga periudha 07/2010 – 10/2013 nuk ka lexim dhe faturim të rregullt, ndërsa ka kërkuar shpërndarjen e shpenzimit 07/2010 deri më 12/2013. KESCO në ankesë ka theksuar se korrigjimi i bërë nga KESCO është bërë për periudhën 07/2010 – 10/2013 si konsumator një tarifor ndërsa DMK ka kalkuluar shpenzimin si konsumator dy tarifor edhe pse shpenzimi është bërë në një tarifë, kur dihet se ka disproporcion të madh mes shpenzimit në tarifën e lartë dhe tarifën e ulët. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_1937_05_19 i datës 10.05.2019 për konsumatorin L.B. me shifër DPR – 41550.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se që gjendja e regjistruar në njehsor në atë periudhë ka qenë në rregull dhe janë korrigjuar faturat e kontestuara, Bordi i ZRRE-së thekson se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.34720077 prej TL=18686 kWh dhe TU=80496 kWh të evidentuar në procesverbalin e inspektimit nr.1976459 të datës 08.04.2016, përputhet me gjendjen e evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive të muajit 03/2016 dhe 04/2016, mirëpo gjatë analizës së bërë rrjedhës së energjisë elektrike dhe transaksioneve të konsumatorit është vërejtur se në muajin 08/2013 nuk kemi lexim të njehsorit elektrik dhe faturim me matje, por kemi faturim pa matje/paushall, po ashtu edhe në muajin 09/2013 nuk kemi lexim të njehsorit elektrik dhe faturim me matje, por kemi faturim pa matje/paushall, ndërsa në muajin 10/2013 kemi lexim dhe faturim me matje prej 13,790 kWh si shpenzim mujor. Pra Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizës së bërë rrjedhës së energjisë elektrike aktive vërehet se në periudhën 12/2013 është bërë përmirësimi i gjendjes së shpenzimit të energjisë elektrike nga gjendja e cila në periudhën 11/2013 ka qenë TL=22466 kWh dhe TU=61890 kWh, në muajin 12/2013 është përmirësuar dhe është bërë TL=16899 kWh dhe TU=63568 kWh, e që shihet se është bërë përmirësimi i gjendjes së shpenzimit në tarifën e lartë prej 5,736 kWh. Andaj edhe pse në periudhën 12/2013 është përputhur gjendja e shpenzimit apo është përmirësuar gjendja e shpenzimit, duhet theksuar se para kësaj periudhe kemi mospërputhje të gjendjes.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se vendimi i DMK në ZRRE thekson se nga periudha 07/2010 – 10/2013 nuk ka lexim dhe faturim të rregullt, ndërsa ka kërkuar shpërndarjen e shpenzimit 07/2010 deri më 12/2013, Bordi i ZRRE-së thekson se organi i shkallës së parë ka vepruar drejtë dhe saktë dhe kjo bazuar në nenin 28, paragrafi 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku është theksuar se: *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*. Për të argumentuar më saktë vendimin e organit të shkallës së parë, Bordi i ZRRE-së ka analizuar detalisht rrjedhën e energjisë elektrike aktive dhe ka vërejtur se konsumatori ka të montuar njehsorin elektrik nr.34120077 prej periudhës 05/2004 e tutje, dhe se konsumatori nga periudha 05/2004 e deri më 06/2010 ka lexim dhe faturim të rregullt, ndërsa nga periudha 07/2010 e deri më 10/2013 nuk ka lexim dhe faturim të rregullt, pasi që është vërejtur se nuk përputhet gjendja e shpenzimit gjatë kësaj periudhe, dhe se përmirësimi i gjendjes ka ndodhur në periudhën 12/2013. Pra Bordi i ZRRE-së thekson se korrigjimi i konsumatorit i përcaktuar në vendimin e organit të shkallës së parë është i saktë dhe i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete, pra korrigjimi duhet të bëhet nga periudha 07/2010 e deri më 12/2013, pra duke e përfshirë periudhën 12/2013 pasi që në atë periudhë është bërë korrigjimi i kWh.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka vërejtur edhe korrespondencat mes DMK në ZRRE dhe KESCO lidhur me kërkesën e DMK në ZRRE për të sigurohet nga KEDS/KESCO procesverbali i inspektimit nr.0706760 i datës 28.11.2013 pasi që sipas urdhër lejimeve nr.59865DPR-41550-41550, nr.59866DPR-41550-41550 dhe nr.59867DPR-41550-41550 të datës 09.01.2014 korrigjimi nga ana e KESCO-s është bërë bazuar në procesverbalin e lartcekur, mirëpo KESCO në përgjigjen e tyre ka theksuar se procesverbali i inspektimit nr.0706760 i datës 28.11.2013 nuk gjendet në dosjen e konsumatorit

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se korrigjimi i KESCO-s është i saktë dhe se DMK ka kalkuluar shpenzimin si konsumator dy tarifor edhe pse shpenzimi është bërë në një tarifë, kur dihet se ka disproporcion të madh mes shfrytëzimit të tarifave, Bordi i ZRRE-së thekson se vendimi i organit të shkallës së parë është i saktë dhe i drejtë e kjo pasi që është bërë shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 07/2010 deri më 12/2013 e kjo bazuar në të dhënat nga shkresat e vet KEDS-it, pra është bërë vetëm shpërndarja e shpenzimit. Për të argumentuar edhe më saktë se korrigjimi i organit të shkallës së parë ka qenë i drejtë dhe i saktë, e dëshmon edhe fakti se gjatë analizimit të shpenzimit të energjisë elektrike është vërejtur se mesatarja mujore e shpenzimit të



energjisë elektrike prej periudhës 05/2004 e deri më 06/2010 është **702.03 kWh/muaj** (periudha para kontestit), ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 12/2013 e deri më 12/2017 është **575.94 kWh/muaj** (periudha pas kontestit). Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe shpenzimin mesatar gjatë shpërndarjeve të ndryshme dhe ka vërejtur se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 07/2010 e deri më 10/2013 është **890.09 kWh/muaj**, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 07/2010 e deri më 12/2010 është **678.74 kWh/muaj**, e që kjo mesatare përputhet me mesataren e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën para dhe pas periudhës kontestuese.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se Departamenti i Faturimit në KESCO me datë 09.01.2014 ka bërë një korigjim financiar në vlerë prej -779.04 €, duke e bërë korigjimin financiar për shkak të leximit jo korrekt e cila ka rezultuar me faturim pa matje dhe se ky korigjim është bërë për periudhën 07/2010 deri më 10/2013 dhe atë bazuar në procesverbalin e inspektimit nr.0706760 të datës 28.11.2013. Ndërsa organi i shkallës së parë gjatë analizimit të shkresave të lëndës thekson se korigjimi financiar i konsumatorit do të duhej të bëhej nga periudha 07/2010 e deri më 12/2013, pra duke e përfshirë periudhën 12/2013 pasi që në atë periudhë është bërë korigjimi i kWh, si dhe duke pasur parasysh se KEDS/KESCO nuk kanë arritur të sigurojnë procesverbalin nr.0706760 të datës 28.11.2013, ka rezultuar se korigjimi i cili duhet t'i bëhet konsumatorit është -1,457.04€.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit L.B. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.